

NUMBER / NUMER

Issue [1] [8], February / March 2009

NEWS FROM GCDO  
 LAJME NGA GCDO

- Solar Power for Gjirokastra Castle / Panele diellore për ndriçimin e Kalasë së Gjirokastrës
- News from GCDO Lajme nga GCDO
- Other News From Gjirokastra Lajme te tjera nga Gjirokastra

WEBSITE

Click to visit the GCDO Home Page

Get Involved!

Click here to find out ways you can get involved in the work GCDO is doing in Gjirokastra

UNSUBSCRIBE

Click to unsubscribe from this email

MAIN STORY

Solar Power for Gjirokastra Castle

Gjirokastra has scored an Albanian first by unveiling a visionary project to illuminate the mediaeval castle using power generated by the sun.



The 50 metre entrance gallery was floodlit by 32 low-energy spotlights powered by a 1.7 kilowatt array of photo-voltaic panels mounted on top of the roof of the old political prison located on the castle roof. The lights were installed after the whole electrical grid of the Gallery was renewed. The effect on the entrance gallery is astonishing. The vaulted entrance gallery, flanked by field guns from the first and second world wars, has until today been a poorly-lit and uninviting space for tourists visiting the castle.

The project has been a joint collaboration between the Gjirokastra Conservation and Development Organisation (GCDO) and GEF Small Grants.

The potential for further generation of solar power is huge. The solar power project is the first phase of an ambitious plan to create a new museum in the castle, and if everything goes according to plan, 70% of the lighting in the new museum will be provided by solar power.

NEWS FROM GCDO

The Swedish Albanian Partnership for Heritage in Gjirokastra

The Cultural Heritage without Borders (CHwB) and GCDO "Gjirokastra 2008 - 2011" programme is well under way. With an extended partnership involving the Ministry of Tourism, Culture, Youth and Sports, the Institute of Monuments of Culture, the Regional Directorate for National Culture in Gjirokastra and the Office for the Coordination and Administration of the City Museum of Gjirokastra, the project has started the researching and surveying works in Gjirokastra.

The project, which will last three years and is funded by the Swedish Foundation CHwB and GCDO, has two main aims: to train international and Albanian students, civil engineers and architects; and to restore two historic buildings within the historic town of Gjirokastra. Two restoration camps a year will be organized in Gjirokastra bringing together experts from Sweden and Balkan countries.

[BACK TO TOP](#)

Lobbying for Albanian Artisanship Reaps Results

Gjirokastra artisans and GCDO staff members participated in the First National Conference of Albanian Artisans along with 60 other artisans from Albania on the 25th and 26th of March 2009. The conference was organized by UNDP and UNESCO's Culture Heritage for Economic Development Program, following on from the successful National Artisan Fair held in Gjirokastra last September.

Just a day before, a draft law for handicrafts was introduced to various institutions by the Ministry of Economy, Trade and Energy and the Ministry of Tourism, Culture, Youth and Sports. Two petitions for this law had been sent by the National Artisan Fairs held in Gjirokastra in 2007 and 2008.

The conference was enriched by the very interesting results of the Artisanship national survey and study carried by SNV (Dutch Development Agency) throughout March 2009. Artisanship needs to be encouraged in Albania and especially in the historical towns like Gjirokastra - SNV announced in their study. As part of this effort a team of experts visited our Artisan Centre and interviewed Gjirokastra artisans.

It is hoped that UNDP and UNESCO's programme for Culture Heritage for Economic Development will provide a big boost to efforts to promote Gjirokastra's cultural heritage in the long-term. Artisanship development and improving tourist access are the main directions Gjirokastra can benefit from.

[BACK TO TOP](#)

Tourist Information Center 2009

Four students from Gjirokastra University's tourism faculty will be interns at the city's Tourist Information Centre this summer. The agreement with the university comes at a time when the TIC, which was established by the GCDO, celebrates its second year of activity. Since March 2007, the TIC has welcomed and offered services to around 9000 tourists and collected valuable information about the needs of tourists and how to improve the sites at Gjirokastra.



[BACK TO TOP](#)

US Ambassador John Withers visits Gjirokastra; USAID meet with GCDO

The American flag flew high over the city as Ambassador John Withers and his wife visited Gjirokastra March 30th - 31st as part of a larger USAID delegation. It was the Ambassador's first visit to the city since arriving in Albania as American ambassador last year. In addition to touring the castle, the historic old bazaar, and the Zekate House, Ambassador Withers found time to attend an elementary school production of "Romeo and Juliet" and read to a class of students at Naim Frasheri School. The Ambassador's main event was the dedication of a new wing in the city's courthouse. Joining the Ambassador was Roberta Mahoney, Mission director of USAID in Albania. Ms. Mahoney and Kristaq Jorgji, Director of Agriculture Projects for USAID, met with GCDO staff to discuss the process of revitalizing Gjirokastra, GCDO's projects in the city and the future of tourism in the region.

[BACK TO TOP](#)

OTHER NEWS FROM GJIROKAstra

Photo Exhibition Reveals Early 20th Century Life in Gjirokastra



A black and white photographic exhibition showing images of Gjirokastra in the first part of the last century opened in Gjirokastra at the beginning of April 2009. The activity was organized by the Regional Directorate of National Culture in Gjirokastra along with the "Dante Aligieri" association and other local authorities. The exhibition casts a fascinating insight about a little known period and shows rare images of the Ali Pasha aqueduct, buildings that have since disappeared on the southern part of the Castle Hill and images of Gjirokastra Castle before the Castle prison was built.

[BACK TO TOP](#)

The first Albanian documentary dedicated to Ismail Kadare started

Top Channel is producing a documentary dedicated to the life and activity of the famous Gjirokastrit writer. Filming began recently in Gjirokastra in the native house of Ismail Kadare, currently under restoration. The 73-year old writer led crew members on a tour of his house, sharing stories of his childhood famously depicted in the novel "Chronicle in Stone". The GCDO gifted Mr. Kadare a copy of their project for a new museum in Gjirokastra's castle, currently named after his novel. The documentary will be the first Albanian project reflecting on the life of Kadare. The director of the documentary is Pirro Milkani.



[BACK TO TOP](#)

HISTORIA KRYESORE

Panele diellore për ndriçimin e Kalasë së Gjirokastrës

Gjirokastra shënoi së fundmi një rekord kombëtar përmes zbatimit të një projekti vizionar për ndriçimin e galerisë hyrëse në kalanë mesjetare përmes energjisë elektrike të prodhuar nga rrezet e diellit. Galeria, me kubetë me qemerë të lartë dhe topat e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore të rreshtuara anash saj, e cila ka pasur një ndriçim të dobët dhe aspak mikpritës për turistët, ka marrë tani një pamje mbresëlënëse që me kontaktin e parë. Në të gjithë gjatësinë prej 50 metra, kjo galeri tani merr ndriçimin dekorativ të 32 llambave me konsum të ulët, që përdorin 1.7 kilovat energji, prodhuar nga panelet voltaike që vendosura në tarracën e burgut të dikurshëm të Kalasë. I gjithë rrjeti elektrik i galerisë u rinovua.

Projekti ishte një bashkëpunim dypalësh i Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës (GCDO)-Fondacioni "Gjirokastra" me programin GEF-Grantet e Vogla.

Mundësitë për përdorimin e energjisë diellore janë shumë të mëdha. Projekti i sapo përfunduar shënon fazën e parë të një plani ambicioz për të krijuar në Kala një muze të ri, i cili sipas parashikimit, 70 % të energjisë do ta marrë po ashtu nga panele diellore.

LAJME NGA GCDO

Zhvillimi i mëtejshëm i partneritetit shqiptaro-suedez për trashëgiminë kulturore në Gjirokastrë

Programi i bashkëpunimit "Gjirokastra 2008 - 2011" mes organizatës "Trashëgimi Kulturor pa Kufinj" (CHwB) dhe GCDO-së po hyn në një fazë të re. Arkitektët kanë nisur punën kërkimore në terren dhe nëpër arkiva lidhur me dy banesa të rëndësishme historike të qytetit, që më pas synohet të restaurohen. Tani në partneritet janë përfshirë edhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare në Gjirokastrë dhe Zyra për Administrim dhe Koordinim të Qytetit Muze të Gjirokastrës.

Ky projekt trevjeçar, që financohet nga organizata suedeze "Trashëgimi Kulturor pa Kufinj" dhe GCDO, ka dy qëllime kryesore: restaurimin e dy banesave historike në Gjirokastrë dhe trajnimin e profesionistëve të rinj shqiptarë dhe të huaj. Dy kampe restaurimi do zhvillohen çdo vit duke sjellë së bashku në Gjirokastrë ekspertë dhe profesionistë nga Suedia dhe vende të Ballkanit.

[KTHIM NE FILLIM](#)

Përpjekjet për zhvillimin e Artizanatit Shqiptar japin frute

Artizanë të Gjirokastrës dhe punonjës të GCDO-së, krahas më se 60 artizanëve nga i gjithë vendi, morën pjesë në Konferencën e Parë Kombëtare të Artizanatit, e cila u zhvillua në Tiranë më 25-26 mars 2009. Konferenca u organizua nga programi i përbashkët UNDP- UNESCO "Trashëgimia Kulturor për Zhvillim Ekonomik", në vazhdim të Panairit Kombëtar të Artizanatit, zhvilluar në Gjirokastrë shtatorin e vitit të kaluar. Në një zhvillim paralel GCDO u ftua në paraqitjen e draftit të parë të Ligjit për Artizanatin paraqitur nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës dhe nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Të dyja këto zhvillime kanë qenë në thelbin e peticioneve që forumet e artizanatit të organizuara nga GCDO kishin formuluar gjatë panairëve 2007 dhe 2008 në Gjirokastrë.

Në konferencë u sollën rezultate interesante të studimit të bërë në mars 2009 nga SNV (Agjencia Hollandeze e Zhvillimit) për gjendjen e artizanatit në Shqipëri. Studimi tregoi se, për të zhvilluar potencialet ekonomike që përmban dhe për të ruajtur vlerat kulturore që trashëgon, artizanati ka nevojë urgjente për mbështetje, veçanërisht në qendra historike si Gjirokastra. Ekspertët që kryen studimin patën vizitor Qendrën e Artizanatit në Gjirokastrë, projekt i GCDO-së dhe intervistuan artizanë gjirokastritë. Ka shenja të mbara se programi i përbashkët UNDP-UNESCO "Trashëgimia Kulturor për Zhvillim Ekonomik", do t'i japë një shtytës të re zhvillimit të trashëgimisë kulturore në qytetin e gurtë. Zhvillimi i artizanatit dhe përmirësimi i vizitueshmërisë duken fushat më të mundshme në të cilat Gjirokastra mund të përfitojë.

[KTHIM NE FILLIM](#)

Zyra e Informimit Turistik merr zhvillime të reja

Katër studentë nga Universiteti i Gjirokastrës, dega Turizëm, po bëjnë praktikën mësimore 3 mujore pranë Zyrës së Informimit Turistik (ZIT). Marrëveshja me Universitetin e Gjirokastrës shënon një hap të ri në veprimtarinë e ZIT, e cila mbushi dy vjet veprimtari si projekt i rëndësishëm i GCDO-së. Që nga hapja në mars 2007 ZIT u ka shërbyer rreth 9000 turistëve në Gjirokastrë, si dhe ka mbledhur e përpunuar informacion të vlefshëm për studimin e vizitueshmërisë në Gjirokastrë dhe rrugët e përmirësimit të përvojës që turistët marrin nga vizita në qytet.

[KTHIM NE FILLIM](#)

Ambasadori amerikan John Withers viziton Gjirokastrën ; USAID takon stafin e GCDO-së



Flamuri amerikan u valëvit në Gjirokastrë në 30-31 mars, gjatë vizitës së ambasadorit John Withers dhe zonjës, së bashku me një delegacion të USAID-it. Kjo ishte vizita e parë e ambasadorit në qytet që nga ardhja në Shqipëri vitin e kaluar. Veç vizitës në Kala, Pazarin Karakteristik dhe shtëpinë e Zekateve, ambasadori Withers

ndoqi pjesën Romeo dhe Zhuljeta, të vënë në skenë nga nxënësit e shkollës Naim Frashëri. Qëllimi kryesor i vizitës ishte inagurimi i shërbimit të ri të informimit në Gjakatën e Apelit. Në Gjirokastrë ishte edhe drejtoresha e misionit në Shqipëri të USAID, zonja Roberta Mahoney dhe Kristaq Jorgji, drejtor projekti në këtë organizatë. Ata takuan stafin e GCDO-së për të diskutuar nevojat e rjetëzimit të Gjirokastrës, projektet e GCDO-së në qytet dhe të ardhmen e turizmit në rajon.

[KTHIM NE FILLIM](#)

LAJME TE TJERA NGA GJIROKAstra

Fotoekspozitë që zbuloi pamje të Gjirokastrës në fillim të shekullit XX

Ditët e fundit në Gjirokastrë u hap një ekspozitë fotografike bardhë e zi me pamje nga qyteti i gurtë në fillim të shekullit të kaluar. Aktiviteti u organizua nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare dhe ente të tjera lokale, në bashkëpunim me shoqatën "Dante Aligieri" dhe studion fotografike "Vito" të Gjirokastrës. Fotoekspozita hedh dritë interesante në thelbin e një periudhe jo dhe aq të njohur të jetës së qytetit dhe arkitekturës së tij. Ajo përmban pamje të rralla të ujesjellësit të Ali Pashës, ndërtime për fat të keq i zhdukur në pjesën jugore të Kalasë, si dhe pamje të kësaj të fundit para se të ndërtohej kulla qendrore e burgut të dikurshëm.

[KTHIM NE FILLIM](#)

Merr udhë në Gjirokastrë i pari dokumentar shqiptar për Ismail Kadarenë

Top Channel nisi punë për prodhimin e një dokumentari kushtuar jetës dhe veprës së shkrimtarit të famshëm. Xhirimet filluan këto ditë në shtëpinë e tij të lindjes në Gjirokastrë, e cila është në proces restaurimi. Shkrimtari 73-vjeçar udhëhoqi grupin e xhirimit nëpër shtëpinë e tij, duke sjellë kujtimet e fëmijërisë, një pjesë të të cilave ai i ka skalitur në romanin "Kronikë në Gur" GCDO i dhuroi shkrimtarit një kopje të projektit për një muze të ri në Kala, që ka huazuar emrin e romanit të famshëm. Dokumentari do jetë i pari produksion kushtuar tërësisht jetës dhe veprës së Kadaresë. Regjisor i dokumentarit është Pirro Milkani.

[KTHIM NE FILLIM](#)